



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1781/3 prot.

Pukë, më 20 .10 .2025

PROCESVERBAL I MBLEDHJES Së KËSHILLIT BASHKIAK PUKË
date 17 .10 .2025


Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 53, pika 3, shkronja "a" si dhe të nenit 56 të VKB nr. 14 datë 30.06.2020 "Rregullore e funksionimit të Këshillit të Bashkisë Pukë" dhe në zbatim të vendimit të kryesisë së këshillit nr. 6 datë 10.10.2025, mbledhja e radhës e këshillit Bashkiak Pukë u zhvillua me datën **17 .10 .2025**, ora **13³⁰** tek salla e Këshillit të Bashkisë Pukë, me këtë rend - dite: :

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 04.09.2025
2. Projekt-vendim : Për miratimin e dhënies së ndihmës ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit **Gusht 2025**.
3. Projekt- vendim : Për rishqyrtimin e VKB nr.28 date 04.09.2025 "Për heqjen nga kontabiliteti i detyrimeve të prapambetura, që nuk justifikohen me dokumentacion financiar dhe ligjor" pas mosmiratimit nga Prefekti i Qarkut Shkodër.
4. Projekt-Vendim : "Për një ndryshim në VKB nr. 64 datë 27.12.2024 " Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm 2025-2027(i ndryshuar)"
5. Projekt-vendim: " Për miratimin e anekseve të monitorimit të buxhetit , 4-mujori i dytë i vitit 2025"

6. Projekt-vendim : " Per dhënien e titullit " Qytetar Nderi" i Bashkisë Pukë Z. Beqir Arifaj (pas vdekjes)
7. Projekt-vendim : " Per dhënien e titullit " Qytetar Nderi" i Bashkisë Pukë Z. Fahri Bukuroshi (pas vdekjes)
8. Projekt-vendim : " Për emërtim sheshe në territorin e Bashkisë Pukë", një shtesë në VKB nr.47 datë 17.12.2004 " Për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe institucioneve të Bashkisë Pukë"
9. Projekt-vendim : " Për emërtim rruge në territorin e Bashkisë Pukë", një shtesë në VKB nr.47 datë 17.12.2004 " Për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe institucioneve të Bashkisë Pukë"
10. Projekt-vendim : " Për vendosje obelisku dhe pllakë "
11. Projekt-vendim " Për dhënien në përdorim nga fondi pyjor të sipërfaqes 0.5 ha për kryerjen e operacioneve të kërkim-zbulimit hidrokarbure, gjeologjike e minerare, uji, vendosje objekteve të ndryshme ndihmëse në sipërfaqe, në ekonominë pyjore Krrab-Bushat , parcelat nr. 48, 49 , në pronësi të Bashkisë Pukë, Subjetit " Kola" sh.p.k
12. Projekt-vendim : Për dhënien e miratimit dhe vazhdimin e procedurës së heqjes nga fondi pyjor publik të sipërfaqes 0.9920 ha dhe pakësimin në volum të sipërfaqeve që do të përdoren për ndërtimin e objektit agroturizëm nga zhvilluesi Xhauri Resort& Spa në ekonominë pyjore Gomsiqe në pronësi të Bashkisë Pukë.
13. Të tjera.

Ne mbledhje moren pjese: Rrok Dodaj , kryetari i Bashkise, Lavdie Terbuni, pergjegjese e zyres sociale , Sokol Gjoni , drejtor i burimeve njerezore, Fiqirete Latifi. Drejtore e Finances, Edmond Prendi, pergjegjës i sektorit te pyjeve, etj

Mbledhja filloi ne oren 13:³⁰ . Jane prezent ne mbledhje 11 keshilltarë , pra eshte koorumi i domosdoshem per fillimin e mbledhjes.



Kryetari i keshillit z. Gjon Gjoka hapi mbledhjen dhe prezantoi projekt-rendin e dites te miratuar nga kryesia, por theksoi se Bashkia ka paraqitur dhe nje projekt-vendim shtese , te cilin kerkon ta shtoje ne rendin e dites

Pas diskutimit te anetareve, u hodh ne votim dhe u miratua rendi i dites me gjithë projekt-vendimin shtese, me 11 vota pro, 0 , vota kunder, 0 vota abstenim.

Pra u shtua projekt-vendimi ” Per miratimin e masave rehabilituese me objekt: Ura auto, fshati Midhe, njesia administrative Qelez, Bashkia Puke, me fondin e kushtezuar te buxhetit te shtetit per mbrojtjen civile”

1. Mbledhja vijoi me **Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së dates 04.09.2025**

U hodh ne votim dhe u miratua **procesverbali i mbledhjes së dates 04 .09.2025** me 11 vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim.

2. Projekt-vendim për miratimin e dhënies së ndihmes ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit **Gusht** 2025.

Pyetje : Gjon Gjoka: A ka ndryshime? A ka kërkesa te tjera?

D.Asani : Pse ka ndryshime? A eshte rrite mireqenia?

D. Asani : A i kontaktoni per te aplikuar per skemen e pikezimit?

Sqaron : Lavdie Terbuni: Ka kërkesa , qe mbesin jashte sistemit te pikezimit, por ne pamundesi per t'i trajtuar te gjithë per mungese fondesh , i trajtojme me radhe.

Jane permiresuar , ose jane larguar.

Jemi ne komunikim te vazhdueshem, pervec rasteve , qe jane te penalizuar per 6 muaj, edhe ne kete rast i njoftojme kur mund te aplikojne.

U hodh ne votim dhe u miratua dhënia e ndihmes ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit **Gusht** 2025. me 11 vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim.

3. Projekt- vendim : Për rishqyrtimin e VKB nr.28 date 04.09.2025 ”Për heqjen nga kontabiliteti i detyrimeve të prapambetura, që nuk justifikohen me dokumentacion financiar dhe ligjor” pas mosmiratimit nga Prefekti i Qarkut Shkodër.

Enver sulejmani : Vendimi 30 i KM eshte ne fuqi. Eshte kompetence e institucionit heqja nga kontabiliteti.

Ndue Lalaj: Prefektura e ka kthyer dhe ka nje arsyetim , ta shqyrtojme pak.

Sqaron : Fiqirete Latifi : Prefektura kerkonte te behet analize. Bashkia i ka njoftuar tre here per dokumenta justifikues. Bashkia kerkon me lehtesuar bilancin nga detyrimet , qe nuk kane dokumenta. Nese i kerkojne permes gjykates , mund te rikthehen perseri. U hodh ne votim dhe u miratua "Për rishqyrtimin e VKB nr.28 date 04.09.2025 "Për heqjen nga kontabiliteti i detyrimeve të prapambetura, që nuk justifikohen me dokumentacion financiar dhe ligjor" pas mosmiratimit nga Prefekti i Qarkut Shkodër." me 11 vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim.

4.Projekt-vendim : "Për një ndryshim në VKB nr. 64 datë 27.12.2024" Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm 2025-2027(i ndryshuar)"

Gjon Gjoka : Jemi per mbarevajtjen e punes ne Bashki. Nuk kemi qene asnjehere kunder. Ne i kemi miratuar rrogat si na i ka sjell administrata e Bashkise.

Sqaron : Fiqirete Latifi : Per ndryshimin e buxhetit ne kemi bere analize. Per klubin sportiv kishim miratuar vetem per 6-mujorin e pare. Kemi bere dy ndryshime , ne dy zera kemi hequr nga njera ane dhe i kemi kaluar te pjesa , qe ka nevojë.

Rrok Dodaj: Eshte hera e trete e ankandit te klubit dhe askush nuk afrohet. Buxheti ka qene vetem per 6-mujorin e pare. Ka dy alternativa , ose me e shkri ekipin , ose me gjete mundesi me perballuar shpenzimet e ekipit. Kjo sa per informacion, nuk kemi ndryshime te tjera.

Ndue Lalaj : Per ekipin duhet te gjendet nje zgjidhje, me nje plan afatgjate, jam per mbeshtetje nga buxheti.

Rrok Dodaj: Tani kushdo , qe mund te afrohet per ta marre ekipin . edhe falas dhe bashkia e mbeshtet.

U hodh ne votim dhe u miratua "Për një ndryshim në VKB nr. 64 datë 27.12.2024 " Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm 2025-2027(i ndryshuar)" , me 11 vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim.

5.Projekt-vendim : Projekt-vendim: " Për miratimin e anekseve të monitorimit të buxhetit , 4-mujori i dytë i vitit 2025"

Sqaron : Fiqirete Latifi : Bashkia ka bere analize sipas parashikimit.

Monitorimi i 4-mujorit te dyte 2025 eshte realizuar ze per ze sipas parashikimit pa ndryshime.

Enver Sulejmani: Me fondet e deleguara duhet te mos digjen .

Fiqirete Latifi: Fondet sektoriale nuk mund te ndryshohen.

U hodh ne votim dhe u miratua Projekt-vendim: " Për miratimin e anekseve të monitorimit të buxhetit , 4-mujori i dytë i vitit 2025" me 11 vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim.

6.Projekt-vendim " Per dhenien e titullit " Qytetar Nderi" i Bashkisë Pukë Z. Beqir Arifaj (pas vdekjes)

Sqaron : Sokol Gjoni : Nje arsyetim per te dy figurat. Kemi sjell dy persona te rendesishem per Puken dhe pukjanet.Kane lene gjurme te rendesishme ne jeten e qytetit. Vleresimi eshte me rendesi per trashegimine pukjane.

Gjon Gjoka : Lexoi motivacionin per Beqir Arifaj.

U hodh ne votim dhe u miratua Projekt: Per dhenien e titullit " Qytetar Nderi" i Bashkisë Pukë Z. Beqir Arifaj (pas vdekjes) me 11 vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim.

7.Projekt-vendim " Per dhenien e titullit " Qytetar Nderi" i Bashkisë Pukë Z. Fahri Bukuroshi (pas vdekjes)

Sqaron : Sokol Gjoni : Nje arsyetim per te dy figurat. Kemi sjell dy persona te rendesishem per Puken dhe pukjanet.Kane lene gjurme te rendesishme ne jeten e qytetit. Vleresimi eshte me rendesi per trashegimine pukjane.

Gjon Gjoka : Lexoi motivacionin per Fahri Bukuroshi.

U hodh ne votim dhe u miratua Projekti: Per dhenien e titullit " Qytetar Nderi" i Bashkisë Pukë Z. Fahri Bukuroshi (pas vdekjes) me 111 vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim.

8. Projekt-vendim :” Për emërtim sheshe në territorin e Bashkisë Pukë”, një shtesë në VKB nr.47 datë 17.12.2004 ” Për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe institucioneve të Bashkisë Pukë”

Sqaron : Lindita Hyseni: Kemi patur propozime nga Myftinia Puke per dy sheshe ne Kabash dhe Qerret , para Xhamive perkatese.

U hodh ne votim dhe u miratua Projekti: Për emërtim sheshe në territorin e Bashkisë Pukë”, një shtesë në VKB nr.47 datë 17.12.2004 ” Për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe institucioneve të Bashkisë Pukë” me 11 vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim.

9. Projekt-vendim :” Për emërtim rruge në territorin e Bashkisë Pukë”, një shtesë në VKB nr.47 datë 17.12.2004 ” Për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe institucioneve të Bashkisë Pukë”

Sqaron : Lindita Hyseni: Kemi patur propozim nga Myftinia Puke per nje rruge.

Rrok Dodaj : Propozoj me vendos emrin e rruges Zezaj , te emertohet ”Rruga Elez Hoxha”, kryemyfti i nderuar per Puken.

U hodh ne votim dhe u miratua Projekti: Për emërtim rruge në territorin e Bashkisë Pukë”, një shtesë në VKB nr.47 datë 17.12.2004 ” Për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe institucioneve të Bashkisë Pukë” me 11 vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim.

10. Projekt-vendim :” Për vendosje obelisku dhe pllakë ”

Sqaron : Lindita Hyseni : Kemi patur propozim nga Myftinia Puke per vendosjen e nje obelisku dhe Plakë per Imam Hoxhe Puka.

U hodh ne votim dhe u miratua Projekti: Për vendosje obelisk dhe pllakë me 11 vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim.

11. Projekt-vendim ” Për dhënien në përdorim nga fondi pyjor të sipërfaqes 0.5 ha për kryerjen e operacioneve të kërkim-zbulimit hidrokarbure, gjeologjike e minerare, uji, vendosje objekteve të ndryshme ndihmëse në sipërfaqe, në ekonominë pyjore Krrab-Bushat , parcelat nr. 48, 49 , në pronësi të Bashkisë Pukë, Subjetit ” Kola” sh.p.k

Sqaron : Edmond Prendi: Me projekt-vendimin e paraqitur ne mund te japim vetem siperfaqet ndihmese , lejen e ujit nuk e japim ne , por Ministria perkatese.

Dritan Asani: Shume shpesh keqperdorim pronat. Ne sekretarine e keshillit kerkova kerkesat dhe planbizneset e subjekteve , por nuk ishin depozituar nga sektori perkates. Ne po i japim keto prona dhe nuk shohim ndryshime dhe zhvillim te tyre. Me interesonte kerkesa dhe planbiznesi. Abstenoj per kete projekt-vendim.

Edmond Prendi: E kam une kerkesen , por nuk e kam dorezuar ne sekretari.

Arben Gugaj: Nuk ka probleme me banoret dhe nuk besoj se eshte shtetesim.

U hodh ne votim dhe u miratua Projekti: Për dhënien në përdorim nga fondi pyjor të sipërfaqes 0.5 ha për kryerjen e operacioneve të kërkim-zbulimit hidrokarbure, gjeologjike e minerare, uji, vendosje objektsh të ndryshme ndihmëse në sipërfaqe, në ekonominë pyjore Krrab-Bushat , parcelat nr. 48, 49 , në pronësi të Bashkisë Pukë, Subjetit " Kola" sh.p.k, me 9 vota pro, 0 vota kunder, 1 vota abstenim.

12. Projekt-vendim : Për dhënien e miratimit dhe vazhdimin e procedurës së heqjes nga fondi pyjor publik të sipërfaqes 0.9920 ha dhe pakësimin në volum të sipërfaqeve që do të përdoren për ndërtimin e objektit agroturizëm nga zhvilluesi Xhauri Resort& Spa në ekonominë pyjore Gomsiqe në pronësi të Bashkisë Pukë.

Rrok Dodaj: Kemi kaluar me Vendim te keshillit bashkiak, per zhvillim 20 ha ne Qafe-Qerreti. Per 10 ha prej tyre ka fituar ankandin subjekti zhvillues XhauriResort&Spa, ka paguar taksat vitin e kaluar. Tani po kerkon lejen e ndertimit , por paraprakisht kerkohet heqja nga fond pyjor dhe kthimi ne truall, kjo procedure realizohet nga Ministria perkatese. Do te kerkoj qe sa me pare te zhvilloje zonen.

Enver Sulejmani : Jam dakord , qe ta miratojme edhe ne kuader te paketes se maleve.

U hodh ne votim dhe u miratua Projekti: Për dhënien e miratimit dhe vazhdimin e procedurës së heqjes nga fondi pyjor publik të sipërfaqes 0.9920 ha dhe pakësimin në volum të sipërfaqeve që do të përdoren për ndërtimin e objektit agroturizëm nga zhvilluesi Xhauri Resort& Spa në ekonominë pyjore Gomsiqe në pronësi të Bashkisë Pukë, me 10 vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim.

13. Te tjera:



Projekt-vendim ” Per miratimin e masave rehabilituese me objekt: Ura auto, fshati Midhe, njesia administrative Qelez, Bashkia Puke, me fondin e kushtezuar te buxhetit te shtetit per mbrojtjen civile”

Sqaron : Behar Ademi : Ne mbledhjen e meparshme jane miratuar dy vendime , ku eshte percaktuar buxheti nga fondet e emergjencave civile. Pas lidhjes se kontratave eshte kursyer nje buxhet , te cilin e kemi menduar ta per perdorim per ndertimin e nje ure auto ne fshatin Midhe, Nj.A.Qelez.

U hodh ne votim dhe u miratua Projekti: Per miratimin e masave rehabilituese me objekt: Ura auto, fshati Midhe, njesia administrative Qelez, Bashkia Puke, me fondin e kushtezuar te buxhetit te shtetit per mbrojtjen civile” me 10 vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim.

Rrok Dodaj: Informim i keshillit per punen dhe kontratat qe po bejme me fondin e zhvillimit , ku kemi perfutur baze materiale.


Ne vijim u lexua propozimi i komisionit te barazise Gjimore drejtuar kryetarit te Bashkise Puke.


Kerkese e nje grupi keshilltaresh zbatimin e ligjit per linjat interurbane ne qytetin e Pukes.

Arben Gugaj: Kerojme qe autobuzat e linjave interurbane te kalojne ne unazen e madhe te qytetit dhe te mos kalojne ne qytet. Per ato qe e shkelin kete rregull te gjobiten.

Rrok Dodaj: Do te marrim masa qe te gjobiten ato , qe shkelin ligjin, pra duhet te kalojne vetem ne unazen e madhe.

Kerkese e nje grupi qytetaresh nga fshati Dedaj, Nj. A. Qelez. Ne lidhje me kerkesen e z. Mark Kol Gjergji per rrugen , jemi kunder ankeses se tij, pasi ai e ka rrugen si te gjithe fshati. Ne jena ketu me ju informu se si eshte situata , ne jemi ne te drejten dhe ne pronen tone.





Enea Sahjani



ALFONS GJERGJA



Aleksander Frideri




Alone baby



Gjon Goka


Arben Fuzaj


Lore Kolaj


Shpresa Remaj

Meson Kuci


sekretari i keshtillit

Harbi Tonburi



